

**L I G J**  
**Nr.7832/1, datë 16.6.1994**

**PËR MIRATIMIN ME NDRYSHIME TË DEKRETIT NR. 831, DATË 24.4.1994 “PËR DISA NDRYSHIME NË DEKRETIN NR. 7463, DATË 31.1.1991 “PËR POLICINË FINANCIARE”**

Në mbështetje të nenve 16 dhe 28 të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”,

**KUVENDI POPULLOR**  
**I RËPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I :**

**Neni 1**

Miratohet dekreti nr. 831, date 24.4.1994 “Për disa ndryshime në dekretin nr. 7463, datë 31.1.1991 “Për Policinë Financiare” me ndryshimet si me poshtë :

- Në nenin 3, shkronja “c” riformulohet si vijon : “Të kontrollojë sistematikisht dhe të zbulojë ushtrimin e veprimtarisë ekonomike pa leje, blerjen për shitje dhe të cdo veprimtarie tjetër shitblerje të mallrave dhe të kryerjes së shërbimeve pa leje me qëllim fitimi, të marrë masa për ndalimin e tyre, si dhe të mbajë procesverbal për shkeljet e vrejtura”

- Në nenin 4, shkronja “b” riformulohet si vijon : “Të hyjë me miratimin e organit kompetent në banesa kur ka të dhëna për ushtrimin e veprimtarive ekonomike të kundraligjshme. Për shkeljet e vrejtura të mbaje proces verbal dhe të sigurojë prova të mjaftueshme për sanksionet sipas shkeljes së konstatuar.”

- Në nenin 5, në fund të paragrafit të dytë shtohet një fjali me këtë përmbajtje : “Përcaktimi i masës së gjobës sipas llojit të shkeljes të bëhet me udhëzim të Ministrisë së Financave.”

- Paragrafi që shtohet pas paragrafit të dytë të nenit 5 riformulohet si vijon : “Për vjeljen e detyrimit sipas vendimit të dënimit, drejtori i Policisë Financiare ose Kryetari i Degës së Policisë Financiare në rreth nxjerr urdhër bllokimi për llogaritë rrjedhëse për subjektet e proceduara në masën e dënimit të dhenë. Urdhër bllokimi është i detyrueshëm për organet bankare deri në marrjen e vendimit të formës së prerë që përbën titull ekzekutiv për organet bankare.”

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

**Shpallur me dekretin nr.872, datë 28.6.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.**